



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi në lidhje me transaksionin e blerjes së shoqërisë Avon Products nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.

Palët pjesëmarrëse:

Natura Cosméticos S.A. është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit Brazilian, me objekt aktiviteti; shitja me shumicë e produkteve kozmetike dhe produkteve të tualetit, artikujve dhe aksesorëve të veshjeve e bizhuterive, pajisjeve kompjuterike, librave, gazetave dhe botime të tjera, medikamenteve dhe ilaçeve për përdorim njerëzor, etj.

Grupi i shoqërive të Natura nuk ka asnjë prezencë të regjistruar dhe nuk ka realizuar asnjë xhiro në Shqipëri.

Avon Products, Inc është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të SHBA-së. Ajo është prodhues global dhe tregtues i produkteve të bukurisë dhe produkteve të lidhura me to. Biznesi i Avon kryhet kryesisht me shitje direkt dhe përfshin shitjen e produkteve të bukurisë, të modës dhe të shtëpisë.

Në Shqipëri Avon është prezent nëpërmjet shoqërisë Avon Cosmetics Albania SHPK, shoqëri e cila ka për objekt aktiviteti: Import, eksporti dhe tregtim i produkteve kozmetike.

Avon Cosmetics Albania SHPK, kontrollohet nga shoqëria Avon Cosmetics Limited, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Anglisë dhe Wellsit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës. Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda shtatë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.